



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

 Zyra e Guvernatorit Kabinet Guvernors Governor's Office	
E Dërguar: Përdalo: Send to:	DMB
Data: Datum: Date:	05.04.24
Nr: Br: No:	270-0-24

Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -150, dhe nenin 85 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, si dhe në zbatim të nenit 11 të Rregullores për Raportimin e Bankave, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 3 prill 2024, miratojkëtë:

UDHËZIM

**PËR RAPORTIMIN E EKSPozIMEVE KREDITORE NGA BANKAT
TË KOMPANIVE QË EKSPozOHEN NDAJ KOSTOVE TË TRANZICIONIT
QË LIDHEN ME ZBATIMIN E MEKANIZMIT TË RREGULLIMIT TË
KUFIRIT TË KARBONIT**

1.

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i këtij Udhëzimi është të përcaktojë mënyrën e plotësimit të formave të raportimit nga bankat dhe degët e bankave të huaja në lidhje me ekspozimet kreditore (ekspozimet bilancore dhe jashtëbilancore) të kompanive që ekspozohen ndaj kostove të tranzicionit që lidhen me zbatimin e mekanizmit të rregullimit të kufirit të karbonit (MRrKK).
2. Ky Udhëzim zbatohet për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja të përcaktuara me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe Rregulloren për Raportimin e Bankave, për të raportuar dhe ofruar informacione për qëllime të mbikëqyrjes bankare nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK).

Neni 2

Udhëzime të përgjithshme

1. Për qëllim të këtij Udhëzimi bankat do të raportojnë ekspozimet kreditore të kompanive që merren me prodhimin e mallrave të caktuara të cilat lirojnë sasi të lartë të karbonit dhe paraqesin rrezikun më të madh të rrjedhjes së karbonit, si: çimento, hekur dhe çelik, alumin, plehra, energji elektrike dhe hidrogjen.
2. Për qëllim të identifikimit të mallrave, ky Udhëzim do të zbatohet për mallrat që i përkasin kodeve të nomenklaturës / Listës së kombinuar ('CN') (ang.: Combined Nomenclature - 'CN') të përcaktuara në Shtojcën 2 të këtij Udhëzimi. Kodet CN do të jenë ato sipas Rregullores (EEC) Nr 2658/87 “mbi nomenklaturën tarifore dhe statistikore dhe për tarifën e përbashkët doganore”.
3. Për qëllim të këtij Udhëzimi, gazrat serrë (ang.: greenhouse gases) që lidhen me mallrat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, janë përcaktuar në tabelën sipas Shtojcës 2 të këtij Udhëzimi.

Neni 3

Përgatitja e formularëve

1. Bankave iu kërkohet të përgatisin dhe të dërgojnë Formularët / Format e Raportimit të BQK-së në përputhje me këtë Udhëzim.
2. Të gjitha raportet, të cilat do të dorëzohen nga bankat, duhet të përgatiten në mënyrë konsistente.
3. Të dhënat financiare të bankave duhet të mirëmbahen në atë mënyrë që të sigurojnë që Formularët e Raportimit të BQK-së të mund të përgatiten dhe të plotësohen në përputhje me këtë Udhëzim dhe të paraqesin drejt ekspozimet kreditore të kompanive që ekspozohen ndaj kostove të tranzicionit që lidhen me zbatimin e mekanizmit të rregullimit të kufirit të karbonit.

Neni 4

Mënyra e dorëzimit të formularëve dhe datat e dorëzimit

1. Secila bankë duhet të dorëzoj Formularët e Raportimit të BQK-së në mënyrën e mëposhtme:
 - 1.1. Dorëzimi i Formularëve të Raportimit do të bëhet me email në Departamentin e Mbikëqyrjes Bankare sipas formularëve të përgatitur nga BQK. Dorëzimi i formularëve të raportimit mund të bëhet edhe në forma tjera të përcaktuara nga BQK.
 - 1.2. Bankat janë përgjegjëse për saktësinë e të dhënave të raportuara. Çdo bankë është përgjegjëse për të siguruar që të dhënat e raportuara për çdo periudhë reflektojnë plotësisht dhe me saktësi kërkesat për raportimin e zërit/zërave për atë datë raportuese, duke përfshirë çdo ndryshim që mund të bëhet në ndërkohë.
 - 1.3. Bankat janë të obliguara të dorëzojnë në BQK format e raportimit jo më vonë se 30 ditë kalendarike pas përfundimit të çdo tremujori.

Neni 5

Shtojcat

Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi është Shtojca 1 dhe Shtojca 2.

Neni 6

Dispozitat kalimtare

1. Raportimi fillestar sipas këtij Udhëzimi duhet të kryhet deri më 31 korrik 2024 për tremujorin II të vitit 2024.
2. Pajtueshmëria e plotë me kërkesat e këtij Udhëzimi duhet të arrihet deri më 30 shtator 2024, përkatësisht me raportimin për tremujorin III të vitit 2024, i cili duhet të kryhet deri më 31 tetor 2024.

Neni 7

Miratimi dhe hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi më 5 prill 2024.



Ahmet Ismaili
Kryesues i Bordit Ekzekutiv

Shtojcë 1
Formularët e Raportimit

Formulari 1 i BQK-së – Ekspozimet Kreditore të Kompanive që Eksportojnë Mallra në Vendet e Bashkimit Evropian

Formulari ka për qëllim të paraqesë shumën e ekspozimeve kreditore të kompanive në Kosovë që prodhojnë dhe eksportojnë në Bashkimin Evropian mallra të cilat lirojnë sasi të lartë të karbonit dhe paraqesin rrezikun më të madh të rrjedhjes së karbonit, si: çimento, hekur dhe çelik, alumini, plehra, energji elektrike dhe hidrogjen.

F1. Ekspozimet Kreditore të Kompanive që Eksportojnë Mallra në Vendet e Bashkimit Evropian
Emri i Bankës:
Periudha e raportimit
Shprehur në (000 Euro)

Rendi	Emri / Emri i Grupit	Personat e ndërlidhur me bankën	Sektori Institucional	Sektori Ekonomik	Mallrat e prodhuara sipas udhëzimit për raportim	Klasifikimi i Ekspozimeve Kreditore	Ekspozimet në Bilanc të Gjendjes		Ekspozimet Jashtë Bilancore		Gjithsej Ekspozimet	Shuma e Kolate realizuar	Gjithsej Rezerva për Humbjet nga Kreditë dhe Provizionet	Data e maturimit
							Kreditë dhe paradhëniet	Të tjera	Zotimet e pashfrytëzuara të parevokueshme	Të tjera				
1											-			xx.xx.20xx
2											-			xx.xx.20xx
3											-			xx.xx.20xx
4											-			xx.xx.20xx
5											-			xx.xx.20xx
6											-			xx.xx.20xx
7											-			xx.xx.20xx
8											-			xx.xx.20xx
9											-			xx.xx.20xx
10											-			xx.xx.20xx
11											-			xx.xx.20xx
12											-			xx.xx.20xx
13											-			xx.xx.20xx
14											-			xx.xx.20xx
15											-			xx.xx.20xx
16											-			xx.xx.20xx
17											-			xx.xx.20xx
18											-			xx.xx.20xx
19											-			xx.xx.20xx
20											-			xx.xx.20xx
21											-			xx.xx.20xx
22											-			xx.xx.20xx
23											-			xx.xx.20xx
24											-			xx.xx.20xx
25											-			xx.xx.20xx
26											-			xx.xx.20xx
27											-			xx.xx.20xx
28											-			xx.xx.20xx
29											-			xx.xx.20xx
30											-			xx.xx.20xx
Gjithsej											-			xx.xx.20xx

Formulari 2 i BQK-së – Ekspozimet Kreditore të Kompanive që nuk Eksportojnë Mallra në Vendet e Bashkimit Evropian

Formulari ka për qëllim të paraqesë shumën e ekspozimeve kreditore të kompanive në Kosovë që prodhojnë, por **nuk** eksportojnë në Bashkimin Evropian mallra të cilat lirojnë sasi të lartë të karbonit dhe paraqesin rrezikun më të madh të rrjedhjes së karbonit, si: çimento, hekur dhe çelik, alumin, plehra, energji elektrike dhe hidrogjen.

F2. Ekspozimet Kreditore të Kompanive që nuk Eksportojnë Mallra në Vendet e Bashkimit Evropian

Emri i Bankës:

Periudha e raportimit

Shprehur në (000 Euro)

Rendi	Emri / Emri i Grupit	Personat e ndërlidhur me bankën	Sektori Institucional	Sektori Ekonomik	Mallrat e prodhuara sipas udhëzimit për raportim	Klasifikimi i Ekspozimeve Kreditore	Ekspozimet në Bilanc të Gjendjes		Ekspozimet Jashtë Bilancore		Gjithsej Ekspozimet	Shuma e Kolateralizuar	Gjithsej Rezerva për Humbjet nga Kreditë dhe Provizionet	Data e maturimit
							Kreditë dhe paradhëniet	Të tjera	Zotimet e pashfrytëzuara të parevokueshme	Të tjera				
1														xx.xx.20xx
2														xx.xx.20xx
3														xx.xx.20xx
4														xx.xx.20xx
5														xx.xx.20xx
6														xx.xx.20xx
7														xx.xx.20xx
8														xx.xx.20xx
9														xx.xx.20xx
10														xx.xx.20xx
11														xx.xx.20xx
12														xx.xx.20xx
13														xx.xx.20xx
14														xx.xx.20xx
15														xx.xx.20xx
16														xx.xx.20xx
17														xx.xx.20xx
18														xx.xx.20xx
19														xx.xx.20xx
20														xx.xx.20xx
21														xx.xx.20xx
22														xx.xx.20xx
23														xx.xx.20xx
24														xx.xx.20xx
25														xx.xx.20xx
26														xx.xx.20xx
27														xx.xx.20xx
28														xx.xx.20xx
29														xx.xx.20xx
30														xx.xx.20xx
Gjithsej														xx.xx.20xx

Formulari 3 i BQK-së – Gjithsej Ekspozimet Kreditore

Formulari ka për qëllim të paraqesë shumën e ekspozimeve kreditore të të gjitha kompanive në Kosovë (pa marrë parasysh se a eksportojnë apo jo në vendet e Bashkimit Evropian) që prodhojnë mallra të cilat lirojnë sasi të lartë të karbonit dhe paraqesin rrezikun më të madh të rrjedhjes së karbonit, si: çimento, hekur dhe çelik, alumin, plehra, energji elektrike dhe hidrogjen.

Rendi	Emri / Emri i Grupit	Personat e ndërlidhur me bankën	Sektori Institucional	Sektori Ekonomik	Mallrat e prodhuara sipas udhëzimit për raportim	Klasifikimi i Ekspozimeve Kreditore	Ekspozimet në Bilanc të Gjendjes		Ekspozimet Jashtë Bilancore		Gjithsej Ekspozimet	Shuma e Kolateralizuar	Gjithsej Rezerva për Humbjet nga Kreditë dhe Provizionet	Data e maturimit
							Kreditë dhe paradhëniet	Të tjera	Zotimet e pashfrytëzuara të parevokueshme	Të tjera				
1											-			xx.xx.20xx
2											-			xx.xx.20xx
3											-			xx.xx.20xx
4											-			xx.xx.20xx
5											-			xx.xx.20xx
6											-			xx.xx.20xx
7											-			xx.xx.20xx
8											-			xx.xx.20xx
9											-			xx.xx.20xx
10											-			xx.xx.20xx
11											-			xx.xx.20xx
12											-			xx.xx.20xx
13											-			xx.xx.20xx
14											-			xx.xx.20xx
15											-			xx.xx.20xx
16											-			xx.xx.20xx
17											-			xx.xx.20xx
18											-			xx.xx.20xx
19											-			xx.xx.20xx
20											-			xx.xx.20xx
21											-			xx.xx.20xx
22											-			xx.xx.20xx
23											-			xx.xx.20xx
24											-			xx.xx.20xx
25											-			xx.xx.20xx
26											-			xx.xx.20xx
27											-			xx.xx.20xx
28											-			xx.xx.20xx
29											-			xx.xx.20xx
30											-			xx.xx.20xx
Gjithsej											-			xx.xx.20xx

8

Shtojcë 2

Nomenklatura /Lista e Kodeve të kombinuara “CN” (ang.: Combined Nomenclature - ‘CN’)

Çimento

Kodi CN	Gazi serrë / Greenhouse gas
2507 00 80 – Argjila të tjera kaolinik	Dioksid karboni
2523 10 00 – Klinker çimentoje	Dioksid karboni
2523 21 00 – Çimento Portland i bardhë, nëse është apo jo i ngjyrosur artificialisht	Dioksid karboni
2523 29 00 – Çimento tjetër Portland	Dioksid karboni
2523 30 00 – Çimento alumini	Dioksid karboni
2523 90 00 – Çimento të tjera hidraulike	Dioksid karboni

Energji elektrike

Kodi CN	Gazi serrë / Greenhouse gas
2716 00 00 – Energjia elektrike	Dioksid karboni

Plehra

Kodi CN	Gazi serrë / Greenhouse gas
2808 00 00 – Acidi nitrik; acidet sulfonitrik	Dioksidi i karbonit dhe oksidi i azotit
2814 – Amoniak, anhidrik ose në tretësirë ujore	Dioksid karboni
2834 21 00 – Nitratat e kaliumit	Dioksidi i karbonit dhe oksidi i azotit
Plehra minerale ose kimike , azotike	Dioksidi i karbonit dhe oksidi i azotit
Plehra minerale ose kimike që përmbajnë dy ose tre elementë plehërues azot, fosfor dhe kalium; plehra të tjerë ; mallrat e këtij kapitulli në tableta ose forma të ngjashme ose në pako me një peshë bruto jo më të madhe se 10 kg Përveç: 3105 60 00 - Plehtrat minerale ose kimike që përmbajnë dy elementët plehërues fosfor dhe kalium	Dioksidi i karbonit dhe oksidi i azotit

Hekur dhe çelik

Kodi CN	Gazi serrë / Greenhouse gas
72 - Hekuri dhe çeliku Me përjashtim të: 7202 2 – Ferro-silicon 7202 30 00 – Ferro-siliko-mangan 7202 50 00 – Ferro-siliko-krom 7202 70 00 – Ferro-molibden 7202 80 00 - Ferro-tungsten dhe ferro-siliko-tungsten 7202 91 00 - Ferro-titan dhe ferro-silico-titanium 7202 92 00 – Ferro-vanadium 7202 93 00 – Ferro-niobium 7202 99 – Të tjera: 7202 99 10 – Ferro-fosfor 7202 99 30 – Ferro-siliko-magnez 7202 99 80 – Tjetër 7204 – Mbetje dhe skrap me ngjyra; rishkrirja e shufrave të skrapit dhe çelikut	Dioksid karboni
2601 12 00 – Xeherore dhe koncentrate të aglomeruara të hekurit, përveç piritëve të hekurit të pjekur	Dioksid karboni
7301 – Shtylla prej fletësh prej hekuri ose çeliku, nëse është apo jo e biruar, e shpuar ose e bërë nga elementë të montuar; kënde, forma dhe seksione të salduara, prej hekuri ose çeliku	Dioksid karboni
7302 - Materiali ndërtimor i shinave hekurudhore ose tramvajit prej hekuri ose çeliku, si më poshtë: shina, shina kontrolli dhe rafti, tehe çelësash, bretkosa kalimtare, shufra pikash dhe pjesë të tjera kalimi, traversa (kryq), pllaka peshku, karrige , pyka karrige, pllaka tabani (pllaka bazë), kapëse hekurudhore, pllaka krevati, lidhëse dhe materiale të tjera të specializuara për bashkimin ose fiksimin e shinave	Dioksid karboni
7303 00 – Tuba, tuba dhe profile të zbrazëta, prej gize	Dioksid karboni
7304 - Tuba, tuba dhe profile të zbrazëta, pa tegela, prej hekuri (përveç gize) ose çeliku	Dioksid karboni
7305 - Tuba dhe tuba të tjerë (për shembull, të salduar, me thumba ose të mbyllura në mënyrë të ngjashme), me seksione tërthore rrethore, diametri i jashtëm i të cilave kalon 406,4 mm, prej hekuri ose çeliku	Dioksid karboni
7306 - Tuba të tjerë, tuba dhe profile të zbrazëta (për shembull, tegel të hapur ose të salduar, me thumba ose të mbyllura në mënyrë të ngjashme), prej hekuri ose çeliku	Dioksid karboni

Kodi CN	Gazi serrë / Greenhouse gas
7307 - Pajisje tubash ose tubash (për shembull, bashkime, bërryla, mëngë), prej hekuri ose çeliku	Dioksid karboni
7308 – Strukturat (me përjashtim të ndërtesave të parafabrikuara të kreut 9406) dhe pjesët e strukturave (për shembull, urat dhe seksionet e urave, portat e mbylljes, kullat, shtyllat e rretës, çatitë, kornizat e çatisë, dyert dhe dritaret dhe kornizat e tyre dhe pragjet për dyer, grila, balustrada, shtylla dhe kolona), prej hekuri ose çeliku; pllaka, shufra, kënde, forma, seksione, tuba dhe të ngjashme, të përgatitura për përdorim në struktura, prej hekuri ose çeliku	Dioksid karboni
7309 00 - Rezervuarë, rezervuarë, vazo dhe kontejnerë të ngjashëm për çdo material (përveç gazit të ngjeshur ose të lëngshëm), prej hekuri ose çeliku, me një kapacitet mbi 300 l, nëse janë ose jo të veshura ose të izoluar nga nxehtësia, por jo të pajisura me mekanike ose pajisje termike	Dioksid karboni
7310 - Rezervuarët, fuçitë, daullet, kanaçet, kutitë dhe kontejnerët e ngjashëm, për çdo material (përveç gazit të ngjeshur ose të lëngshëm), prej hekuri ose çeliku, me një kapacitet jo më të madh se 300 l, nëse janë apo jo të veshura apo të izoluar nga nxehtësia, por nuk është i pajisur me pajisje mekanike ose termike	Dioksid karboni
7311 00 - Kontejnerë për gaz të ngjeshur ose të lëngshëm, prej hekuri ose çeliku	Dioksid karboni
7318 - Vida, bulona, dado, vidhos karrige, grepa me vida, ribatina, kabina, gjilpëra, rondele (përfshirë rondele me susta) dhe artikuj të ngjashëm, prej hekuri ose çeliku	Dioksid karboni
7326 – Artikuj të tjerë prej hekuri ose çeliku	Dioksid karboni

Alumin

Kodi CN	Gazi serrë / Greenhouse gas
7601 - Alumini i papërpunuar	Dioksidi i karbonit dhe perfluorokarburet
7603 - Pluhurat dhe thekonet e aluminit	Dioksidi i karbonit dhe perfluorokarburet
7604 - Shufra, shufra dhe profile alumini	Dioksidi i karbonit dhe perfluorokarburet
7605 - Tela alumini	Dioksidi i karbonit dhe perfluorokarburet

Kodi CN	Gazi serrë / Greenhouse gas
7606 - Pllaka, fletë dhe shirita alumini , me një trashësi më të madhe se 0,2 mm	Dioksidi i karbonit dhe perfluorokarburet
7607 - Letër alumini (nëse është apo jo e printuar ose e mbështetur me letër, karton, plastikë ose materiale të ngjashme mbështetëse) me një trashësi (duke përjashtuar çdo bazë) jo më të madhe se 0,2 mm	Dioksidi i karbonit dhe perfluorokarburet
7608 - Tuba dhe tuba alumini	Dioksidi i karbonit dhe perfluorokarburet
7609 00 00 - Pajisje për tuba ose tuba alumini (për shembull, bashkime, bërriyla, mëngë)	Dioksidi i karbonit dhe perfluorokarburet
7610 – Strukturat e aluminit (me përjashtim të ndërtesave të parafabrikuara të kreut 9406) dhe pjesët e strukturave (për shembull, urat dhe seksionet e urave, kullat, shtyllat e rrjetave, çatitë, kornizat e çatisë, dyert dhe dritaret dhe kornizat e tyre dhe pragjet për dyer, balustrada, shtylla dhe kolonat); pllaka alumini , shufra, profile, tuba dhe të ngjashme, të përgatitura për përdorim në struktura	Dioksidi i karbonit dhe perfluorokarburet
7611 00 00 - Rezervuarë, rezervuarë, vazo alumini dhe kontejnerë të ngjashëm, për çdo material (përveç gazit të ngjeshur ose të lëngshëm), me një kapacitet më të madh se 300 litra , nëse janë ose jo të veshura ose të izoluar nga nxehtësia, por jo të pajisur me pajisje mekanike ose termike	Dioksidi i karbonit dhe perfluorokarburet
7612 - Kavanoza alumini , daulle, kanaçe, kuti dhe kontejnerë të ngjashëm (përfshirë kontejnerët tubarë të ngurtë ose të palosshëm), për çdo material (përveç gazit të ngjeshur ose të lëngshëm), me një kapacitet jo më të madh se 300 litra , nëse janë ose jo të veshura ose të izoluar nga nxehtësia , por jo të pajisur me pajisje mekanike ose termike	Dioksidi i karbonit dhe perfluorokarburet
7613 00 00 - Kontejnerë alumini për gaz të ngjeshur ose të lëngshëm	Dioksidi i karbonit dhe perfluorokarburet
7614 - Tela, kabllot, shiritat e thurur dhe të ngjashme, prej alumini, të paizoluara elektrikisht	Dioksidi i karbonit dhe perfluorokarburet
7616 – Artikuj të tjerë prej alumini	Dioksidi i karbonit dhe perfluorokarburet

Kimikatet

Kodi CN	Gazi serrë / Greenhouse gas
2804 10 00 – Hidrogjen	Dioksid karboni